



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ÇËSHTJEVE JURIDIKE

SHIPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE  
DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

SPECIALIST PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Në zbatim të nenit 22 dhe 25 të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe kreut II, III, IV dhe V, të Vendimit nr.243 datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", Bashkia Roskovec shpall Procedurat e lëvizjes paralele dhe e pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

**Një vend pune** në pozicionin Specialist për Mbrojtjen e Mjedisit në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit,

- Kategoria e pagës IV-a.

Pozicioni i më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në Shërbimin Civil

**Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe pranimin në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!**

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

**LËVIZJE PARALELE**

**18/10/2024**

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

**PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

**23/10/2024**

- Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist për Mbrojtjen e Mjedisit:

Është nëpunës civil dhe ka varësi direkte nga Përgjegjësi i Sektorit. Detyrat dhe përgjegjësitë janë:

- Zhvillimi i politikave, planeve, monitorimi dhe edukimi për mbrojtjen e mjedisit urban, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e treziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës së banorëve;
- Monitorimi dhe/ose kontrolli i procesit të dhënies së lejeve mjedisore (pëlqimi mjedisor) dhe shprehja e opinionit për lejet e shfrytëzimit për çdo kërkesë që kalon nga bashkia;
- Ideimi, drejtimi dhe koordinimi i procesit të hartimit të “planit vendor të veprimit për mjedisin” si pjesë e planit përgjithshëm të zhvillimit ;
- Vlerësim dhe monitorim të politikave të zhvillimit mjedisor në planifikime vendore (masterplane) dhe planifikime vendore sektoriale (mikroplane), në kuadër të respektimit të cilësisë dhe parametrave teknike mjedisore;
- Vlerësimi, monitorimi dhe kontrolli në politikat dhe projektet e trajtimit të mbetjeve urbane dhe të përpunimit të tyre;
- Vlerësimi, monitorimi dhe kontrolli në politikat dhe projektet që lidhen me zonat problematike mjedisore (të ndotjes nga proceset hidrokarbure, zona të ndotura, zona të degraduara);
- Vlerësimi, monitorimi dhe kontrolli në politikat dhe projektet e përmirësimit të gjelbërimit në territorin e Bashkisë Roskovec;
- Vlerësimi, monitorimi dhe kontrolli në politikat dhe projektet dhe strategjitet e cilësisë së ajrit, ujit, etj;
- Mbi bazën e ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, kontrollon hartimin dhe zbatimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis për projektet e zhvillimit të cilat propozohen në Bashkinë Roskovec nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit;
- Koordinimi i punës për promovimin e politikave mjedisore me Njësitë Administrative në varësi;
- Drejtimin e punës për (orientimin, sqarimin dhe përmirësimin e politikave mjedisore në tërësi në punën e administratës së Bashkisë);
- Vlerësimi i prioriteteve të qytetarëve për cilësinë e mjedisit, dhe vlerësimi i kënaqshmërisë qytetare për treguesit e cilësisë së mjedisit;

## I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e lëvizjes paralele janë:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori,
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zoterojë një Diplomë Universitare të nivelit minimal “Bachelor” në Shkenca Mjedisore. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njoitura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjisacionit në fuqi*).

- b) Të kenë eksperiencë pune mbi 1 vit.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d) Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj.

## 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të dërgojë dorazi në një zarf të myllur, në zyrën e Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Roskovec, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje të një vleresimi vjetor.
- Fotokopje të aktit të konfirmimit të Statusit të nepunësit civil.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
- Vërtetim gjëndjes shëndetsore;

*Dokumentet duhet të dorëzohen në institucion, brenda datës 18/10/2024.*

## 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **20/10/2024**, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkisë Roskovec do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe në stenden e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Roskovec, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, paraqesin ankesat me shkrim pranë Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Roskovec. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e paraqitjes së tyre.

1.4

## FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore,
- Ligji 139/2015;
- Njohuritë mbi ligjin Nr.152/2013 “Për nepunësin civil” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Njohuritë mbi ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Njohuritë mbi ligjin Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar
- Njohuritë mbi ligjin Nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”
- Ligjin Nr 10 431 datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar;

1.5

## MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë, i ndarë në: 20 pikë përvojë, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse dhe 10 pikë për çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohet me 60 pikë.

Totali i pikëve është 100 pikë.

1.6

## DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Për datën dhe vandin e konkurimit kandidatët do të njoftohen nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Roskovec.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e Bashkisë Roskovec do të shpallë fituesin në Faqen Zyrtare të Bashkisë Roskovec dhe në portalin e “Shërbimit Kombëtar të Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

### 2- Pranimi në Shërbimin Civil

*Vetëm në rast se pozicioni i publikuar në këtë shpallje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ky pozicion do të jetë i vlefshëm për konkurm nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil.*

*Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë personat që janë jashtë shërbimit civil.*

## 2.1

### KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil:**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- Të zotërojë një Diplomë Universitare të nivelit minimal "Bachelor" në Shkenca Mjedisore. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të janë të njoitura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislativit në fuqi*).
- Të kenë eksperiencë pune deri në 1 vit,
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj.

## 2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:**

- Jetëshkrim;
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Çdo dokumentacion tjeter që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore.

*Dokumentet duhet të dorëzohen në institucionin e Bashkisë Roskovec, brenda datës 23/10/2024*

## 2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 01/11/2024, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e Bashkisë Roskovec do të shpallë në portalin e "Shërbimit Kombëtar të Punësimit", në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e Bashkisë Roskovec, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e njoftimit individual, paraqesin ankesat me shkrim pranë Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Roskovec. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e depozitimit të ankesës.

## 2.4

### FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore;
- Ligji 139/2015;
- Njohuritë mbi ligjin Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Njohuritë mbi ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Njohuritë mbi ligjin Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar
- Njohuritë mbi ligjin Nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligjin Nr 10 431 datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”i ndryshuar;

## 2.5

### MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përherdhëm i Pranimit, i ngritur pranë Bashkise Roskovec.

Totali i pikeve te vleresimit te kandidateve eshte 100 pike te cilat ndahen perkatesisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

## 2.6

### DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e Bashkisë Roskovec do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritisë në detyrë, do të marrin informacion në faqen e Bashkise Roskovec, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vedin dhe orën ku do të zhvillohet konkuri;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkise Roskovec duke filluar nga data: 01/11/2024

**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**BASHKIA ROSKOVEC**